



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 06

Datë: 09. 03. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes Nr. 05/2023
 - 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullave Zgjedhore**
 - 3. Vlerësimi vjetor për Zëvendës Kryeshefin Ekzekutiv z.Xhemail Peçani.**
 - 4. Të ndryshme !**
-

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, pas hapjes së mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti para anëtarëve të komisionit agjendën e mbledhjes, dhe pyeti nëse dikush ka për të shtuar ndonjë gjë...

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ-së, paraqiti dy propozime: 1. Të rishikohet një afat lidhur me planin operacional: emërimi i anëtarëve të KKZ-ve dhe afati të shtyhet për dy-tri ditë. 2. Dhe këshilli mbikëqyrës për Informim Publik të rritet nga tre, në katër ose pesë anëtarë.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP lidhur me planin operacional, propozoi që të shtyhet afati për aplikim për certifikim të subjekteve politike, deri më 23 mars.

Arianit Elshani, tha se i arsyeton këto kërkesa.

Ilir Gashi, pyeti pse po shtyhet afati për aplikim për certifikim ? Kurse Besnik Buzhala tha se kjo nuk interferon në pjesët tjera të planit, në afatet e planit dhe se zyra mund të bëjë më lehtësisht verifikimin e kandidatëve...

Kreshnik Radoniqi, në vazhdim të mbledhjes propozoi që të rishikohet “lista” e pjesëmarrësve për vëzhgimin e zgjedhjeve në Malin e Zi, më 19 mars 2023.

Në vazhdim, me këto propozime, u miratua rendi i ditës. Pastaj, anëtarët e KQZ-së me 10 vota për, miratuan procesverballi e mbledhjes nr. 05/2023 të KQZ –së.

2. Aktiviteti i Sekretariatit:

Burim Ahmetaj, Shqyrtimi dhe miratimi i shtyrjes së afatit për aplikim për certifikim të subjekteve politike është një aktivitet dhe kjo që po them ndërlidhet me propozova si pikë e rendit të ditës që ta shtyjme afatin për subjektet politike që ti nominojnë anëtarët e KVV-e për Komisionet Komunale Zgjedhore në komunat:

Mitrovicë e Veriut, Zveqan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Data që Sekretariati propozon, është 22 marsi kur KQZ themelon dhe emëron KVV-të.

Besnik Buzhala: Siç e thash më herët, zyra jonë rekomandon ndryshimin e planit të aktiviteti nr. 11 që është periudha për certifikim dhe përfundon me datën 18 mars, të shyhet deri më 22 mars. Kjo periudhë “prej dy ditësh” nuk e rrezikon procesin, pra nuk pengon aktivitetet tjera.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i shtyrjes së afatit për aplikim për certifikim të subjekteve politike që marrin pjesë në zgjedhje:

Ibrahim Selmanaj: Nëse një subjekt nuk ka garue deri më tani, në këtë periudhë a ka të drejtë me aplikue?

Arianit Elshani: Plani operacional preket, si për shembull “periudha për paraqitjen e përmirësime dhe korrigjime nga subjektet politike” që është e planifikuar më 21 mars dhe 22 mars. Pas kësaj, zyra i “shqyrton, korrigjon dhe përgatitë rekomandimin me shkrim për KQZ” ...rrjedhimisht, preken edhe afatet tjera...

Kam si kërkesë që plani operacional të shihet mirë, të kihet kujdes...

Sami Hamiti: Ato dy afate, ndërlidhen me certifikim, janë vazhdimësi nuk prekin në substancë, pra nuk prekin operacionet e tjera... E kemi pas rastin e këtillë edhe në dhjetor...

Alban Krasniqi: Çdo shtyrje e afateve që nuk pengon planin operacional krijon mundësi, dhe se kam fjalën vetëm për këto zgjedhje por edhe tjera, afate tjera. Vetëm, mos të shkactohe precedent se përndryshe, kjo kur se prish planin, është në rregull dhe ndikon pozitivisht...!

Čemailj Kurtiš: Nëse nuk ka problem, nuk e përngon planin s'kemi pse ta komplikojmë, nuk e pengon procesin, unë nuk jam kundër...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për miratim të këtij rekomandimi të Sekretariatit... Me 8 vota për dhe dy abstenime, miratohen rekomandimet për:

1. Shtyrjen e datës për aplikim për certifikim të subjekteve politike deri më 22 mars,
2. Dhe themelimi i KKZ-ve deri më 22 mars.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për plotësimin e Këshillit Mbikëqyrës të Informimit Publik me anëtarë të tjerë

Burim Ahmetaj: Pavarësisht se janë shtyrë zgjedhjet, janë pezulluar vendimi i kaluar është në fuqi ku anëtarë të këtij këshilli janë Fazli Stollaj, kryesues dhe anëtarë: Arianit Elshani dhe Gordana Llaban. Ne rekomandojmë që këshilli të plotësohet, edhe me dy anëtarë ngase, edhe ka qenë prej pesë anëtarëve...

Ibrahim Selmanaj, Sami Hamiti dhe anëtarët e tjerë, kryetari Kreshnik Radoniqi.

Në fund, KMIP u plotësuar me Alban Krasniqin,

Besnik Buzhala: Po...subjektet e regjistrueme në zyre, po mund të aplikojmë...

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullave Zgjedhore:

Kreshnik Radoniqi: A doni me i hapur, shqyrtuar edhe njëherë, rishikuar... ?

Sami Kurteshi: Unë i kam parë, i kam trajtue, lektorue gjuhësisht... Jam përkushtuar tërësisht, janë nënvizimet...por unë mendoj se ka çështje që, duhet ti rishikojmë së bashku...

Diskutuan: Sami Hamiti, Čemailj Kurtiš, Arianit Elshani, Ilir Gashi të cilët, i cilësuan si një punë e madhe e KQZ për një kohë të gjatë...

Në vazhdim, anëtarët e KQZ-së, miratuan rregullat në pake ashtu siç propozoi Ilir Gashi, ndërsa rregullat prej 1 – 5 të miratohen në fund, 3 rregulla zgjedhore për shfuqizim...

Fillimisht, u shfuqizuan:

1. Rregulla Zgjedhore 5/13, Kutitë Postare dhe Komunikimi Elektronik me Subjektet Politike. (Me 10 vota për shfuqizohet)
2. Rregulla Zgjedhore 10/13, Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar Kryetar Komune. (Me 10 vota për shfuqizohet)
3. Rregulla Zgjedhore 11/13, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët. (Me 10 vota për shfuqizohet)

Kreshnik Radoniqi: Vazhdojmë me miratimin e rregullave 1-5:

E kemi rregullën zgjedhore 3/23, Emrimi, Përbërja dhe Funkcionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.

Lidhur me këtë rregull, Sami Kurteshi, tha se nuk ka ndonjë koment dhe se sipas tij, mund të miratohet. Pastaj, edhe Arianit Elshani mbështeti miratimin e kësaj rregulle:

1. Rregulla Zgjedhore 3/23, Emërimi, Përbërja dhe Funkcionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve. (Miratohet me 10 vota.)
2. Rregulla Zgjedhore 4/23, Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës Votuese. (Miratohet me 10 vota.)
3. Rregulla zgjedhore 1 dhe 5, do të diskutohen në fund...!
4. Rregulla Zgjedhore 6/23, Themelimi dhe Ndërimi i Qendrave të Votimit. (Miratohet me 10 vota.)
5. Rregulla Zgjedhore 7/23, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës. (Mbas një shqyrtimi analitik – profesional, kjo rregull u miratua me 10 vota.)
6. Rregulla Zgjedhore nr. 8/23, Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike. (Miratohet me 10 vota.)
7. Rregulla Zgjedhore nr. 9/23, Rregulla Zgjedhore nr. 9/23, Vëzhguesit e Zgjedhjeve. (Miratohet me 10 vota.)
8. Rregulla Zgjedhore nr. 10/23...
9. Rregulla Zgjedhore nr. 11/23, Fletëvotimet dhe Broshurat. (Miratohet me 10 vota.)
10. Rregulla Zgjedhore nr. 12/23, Ndryshimet e Vendvotimeve (Miratohet me 10 vota.)
11. Rregulla Zgjedhore nr. 13/23...
12. Rregulla Zgjedhore nr. 14/13, Rezultatet Preliminare (Miratohet me 9 vota)
13. Rregulla Zgjedhore nr. 15/23, Qendra e Numërimit të Rezultateve. (Miratohet me 9 vota.)
14. Rregulla Zgjedhore nr. 16/23, Zgjedhjet e Parakohshme. (Miratohet me 8 vota)

Kreshnik Radoniqi, ju lutem një digresion: Rregullat që janë shfuqizuar, këto vlejné – këto vlejné për Zgjedhjet Lokale të 23 prillit: rregulla 5/13, 10/13 dhe 11/13 – duhet ta kenë një “aneks vendim” që janë të vlefshme deri në certifikimin e zgjedhjeve të 23 prillit, 2023.

Mbas një pauze të shkurtër, anëtarët e KQZ-së, ashtu siç, u dakorduan në pjesën e parë të mbledhjes shqyrtuan dhe miratuan si në vijim, këto rregulla zgjedhore:

Përpara se të miratohet rregulla nr. 1, u shytua përfundimisht edhe njëherë mbi disa nene, paragrafë, shtojca – referenca nga: Sami Kurteshi, Besnik Buzhala (ZRCKFSP) , Arianit Elshani, Vesa Xharra (ZRCKFSP), Alban Krasniqi, Kreshnik Radoniqi, Sami Hamiti.

15. Rregulla Zgjedhore nr. 1/23, Regjistrimi dhe Funkcionimi i Partive Politike. (Miratohet me 9 vota)

Lidhur me shqyrtimin dhe miratimin e kësaj rregullore, morën pjesë: Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi, Arianit Elshani, Besnik Buzhala.

16. Rregulla Zgjedhore nr. 5/ 23, **Certifikimi i Partive Politike.** (Miratohet me 8 vota)

Në analizë dhe shqyrtim përfundimtarë të rregullës numër 7, morën pjesë: Arianit Elshani, Besnik Buzhala, Sami Hamiti dhe Sami Kurteshi.

17. Rregulla Zgjedhore nr. 7/23., Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës (Miratohet me 9 vota)

18. Rregulla Zgjedhore nr. 10/23, Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta. (Miratohet me 8 vota)

19. Rregulla Zgjedhore nr. 11/23, Fletëvotimet dhe Broshurat. (**Miratohet me 9 vota**)

Në shqyrtimin dhe miratimin e rregullores nr. 12, u diskutua më gjatë dhe më detajisht. U bënë analiza në formulim të neneve dhe paragrafëve në kontekst të “konstituimit dhe miratimit të këshillave”, nga: Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Burim Ahmetaj, Sami Hamiti, Ilir Gashi dhe Alban Krasniqi.

20. Rregulla Zgjedhore nr. 12/23, Këshillat e Vendvotimeve. (Miratohet me 8 vota)

Lidhur me miratimin e rregullës nr. 13, analizat, shqyrtimet dhe diskutimet i bënë: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ilir Gashi, Burim Ahmetaj.

21. Rregulla Zgjedhore nr. 13/23, Votimi dhe Numërimi në Votim dhe në Qendrën e Votimit (Miratohet me 10 vota)

Në fund, Sami Kurteshi kërkoi nga Zyra për Çështje Ligjore që të kihen parasysh çështjet teknike të rregullohen, dhe se kur të nënshkruhen (miratimi i tyre) të kihet parasysh data e nënshkrimit: “9 mars, 2023”...

Dhe, një vendim të bëhet për rregulloret që janë shfuqizua sepse, këto nuk vlejné për zgjedhjet e 23 prillit...

Rregullat e miratuara sipas renditjes:

1. *Rregullore Nr. 01-2023, Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike.*
2. *Rregullore Nr. 02-2023, Emërimin, përbërja dhe funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve.*
3. *Rregullore Nr. 03-2023, Krijimi, konfirmimi dhe kundërshtimi i listës së votuesve.*
4. *Rregullore Nr. 04-2023, Certifikimi i subjekteve politike dhe i kandidatëve të tyre.*
5. *Rregullore Nr. 05-2023, Themelimi dhe ndërrimi i qendrave të votimit.*

6. *Rregullore Nr. 06-2023, Regjistrimi dhe votimi jashtë Kosovës.*
7. *Rregullore Nr. 07-2023, Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike.*
8. *Rregullore Nr. 08-2023, Vëzhguesit e zgjedhjeve.*
9. *Rregullore Nr. 09-2023, Regjistrimi dhe votimi i personave me nevoja të veçanta.*
10. *Rregullore Nr. 10-2023, Fletëvotimet dhe broshurat.*
11. *Rregullore Nr. 11-2023, Këshillat e vendvotimeve.*
12. *Rregullore Nr. 12-2023, Votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i qendrës së votimit.*
13. *Rregullore Nr. 13-2023, Rezultatet preliminare.*
14. *Rregullore Nr. 14-2023, Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve.*
15. *Rregullore Nr. 15-2023, Zgjedhjet e parakohshme.*

Kreshnik Radoniqi: Një punëtori do të mbahet më 13 – 14 mars me NDPA-në, dhe ka të bëjë me strukturimin e “ZRCKFSP”. Takimi, mbahet në Sirius...Anëtarët e KQZ-së janë të ftuar të gjithë, e edhe nga Sekretariati...ndonjë...

Dhe tjetra, lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve në Mal të Zi, se di a kemi kohë, por nëse mundemi që ta dërgojmë emrin edhe për Rifatin... A pajtoheni...? Po, në rregull...

Ndërsa, edhe një informatë: IFES dhe Te Transparency International (TI) kanë dërgua ftesë në ZRCKFSP, dhe zyra ka caktua Mergita Kreyziun, më 18 – 19 prill, 2023. Shpenzimet janë të mbuluara nga nikoqiri...

Burim Ahmetaj: Na duhet një vendim i KQZ-së për zgjatjen e orarit për zgjedhjet.

Me 10 vota për, miratohet.

Arianit Elshani, foli për dy çështje: takimet e shumta me KKZ-të dhe kërkoj që të bëhet një raport se si do të veprojmë sepse, na duhet të marrim veprime... Mos ta kemi ende si çështje, ta adresojmë...më në fund ta zgjidhim...

E dyta, lidhur me publikimet: Le të publikohet çdo material, çdo raport, analizë, thjeshtë çdo vendimi yni... Pra, të publikohet gjithçka në ueb faqen tonë...

Ilir Gashi, tha se është mirë me qenë me ligj, pra të ndikojmë edhe ne, ku të jenë zyrat e KKZ-ve. Ne jemi organ permanent, dhe mendoj se këto zyre të jenë në objektet e Kuvendeve Komunale...

Sami Kurteshi, tha se kjo nuk funksionin ! Unë, sa isha te Avokati i Popullit, komunat e kanë pas me ligj obligim për zyret, por se kanë respektue ligjin...

Burim Ahmetaj, tha se lidhur me Reformen Zgjedhore, ne komentet tona do ti dërgojmë – ti kemi gati deri të hënen...

Aplikimi për votim nga jashtë vendi, po mendojmë me ba përmes softverit, mirëpo në dispozicion ta kemi edhe aplikim përmes imellit...

Diskutuan: Burim Ahmetaj, Alban Krasniqi, i cili diskutoi për sa më shumë mundësi të votimit të votuesve nga jashtë, por edhe për çështjen e zyrave të KKZ-ve, Sami Hamiti, Sami Kurtesh...

6. Vlerësimi vjetor për Zëvendës Krye shefin Ekzekutiv z. Xhemail Peçani

7. Të ndryshme !